



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRI

Nr. 1539 / prot.
114

Tiranë, më 15.05 /2020

URDHËR

Nr. 193 / , datë 15.05 .2020
3

“PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 193 DATË 20.03.2020 “PËR MBYLLJEN APO KUFIZIMIN E LËVIZJEVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të neneve 7, pika 4, dhe 15, të ligjit nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, si edhe në zbatim të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga COVID-19,

URDHËROJ:

Në Urdhrin Nr.193 datë 20.03.2020 “Për kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, bëhet ndryshimi si vijon:

1. Fjalja e fundit e pikës 3, ndryshohet si më poshtë:

“Përjashtim nga ky rregull bëhet për pikat e shitjes së produkteve ushqimore me pakicë dhe farmacitë, të cilat ditën e shtunë, datë 16 Maj 2020, lejohen të ushtrjnë aktivitetin e tyre deri në orën 17:30.”

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Ogerta Manastirliu

